



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2020

Procesverbal

Takimi i I-rë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020

Më 26.02.2020

Në takim prezantuan:

Ylber Bajra, Nënkyrytarë i Komunës

Jaser Jaha, zv.Komandant i Policisë-Kaçanik

Lulzim Uka, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, FOJK

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

Lirije Luta- Komiteti për Komunitete

Zahir Doda-Drejtor i DAK

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Ylber Bajra** dhe propozoi këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Dukuria e vjedhjeve massive në disa lokalitete të komunës së Kaçanikut
4. Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBB-së në vitin 2019
5. Tëndryshme

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Procesverbal u miratua nga të gjithë të pranishmit .

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës Nënkryetari i Komunës fjalën i dha zv.Komendantit të Policisëz.**Jaser Jah**a i cili tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe 2 mujore ka qenë e qetë dhe stabile me përjashtim të disa rasteve të cilat i kemi trajtuar në bazë të veprave të cilat janë kryer.Dukuria e vjedhjeve ka rënë dukshëm falë bashkëpunimit me qytetarë dhe akterë tjerë të sigurisë .Po vazhdohet me planet operative me të gjitha njësitë dhe janë po ato plane që kanë qenë edhe vitin e kaluar .

Kjani Sallahu: Këto ditë ka pasur bastisje në disa lokalitete dhe a mund të kemi informacione rreth këtyre bastisjeve .

Jaser Jaha:Njësitë e caktuara policore nga regjioni janë marrë me kët operacion dhe ne kemi asistuar kur është kërkuar nga ata .Janë gjetë sasi e konsiderueshme armatimi dhe rasti është në procedurë e sipër .

Ramadush Osmani:Çështja e sinjalizimeve të rrugëve magjistrale është një shqetësim i madh . Te kyçja në autostradë mungon ndriçimi e gjithashtu në këtë pjesë ka mungesë të shenjave infordhmuese . Ne jemi duke përgatitur një dosje në lidhje me kët problematikë dhe është mirë që kët shqetësim ta përcjellni edhe të njësiti i policisë së komunikacionit .

Kjani Sallahu: Sinjalizimet horizontale dhe vërtikale në hyrje-daljen e magjistrales në Fushë të Pajtimit nuk janë të rregulluara, pra me sistemin e ri të sinjalizimit kjo hyrje – dalje është ç’rregulluar dhe është e pakuptimtë. Hyrje-dalja është pjesë kyçë e magjistrales dhe rrjedhimisht duhet t’i jepet përparësia segmenteve të magjistrales, e jo rrugës lokale Fushë e Pajtimit – Begracë – Pumpa. Rëndësia e kësaj rruge duhet të kthehet ashtu siç ishte më herët. Poashtu, një situatë të rrezikshme e kemi te nënkalimi i autostradës afér “Shkëndia Petrol”, në Fushë të Pajtimit. Degëzimi i rrugës ndodhet jashtëzakonisht afér nënkalimit dhe në një kthesë të madhe, ndërsa në anën tjetër nga degëzimi në kyçje të rrugës për Doganaj nuk ka shenjë “Stop”, por vetëm shenja që i jep përparësi rrugës kryesore., etj. Këto shkaktojnë hamendje dhe rrezik.

Jaser Jaha : Shqetësimet në lidhje me mungesën e sinjalizimeve në kët pjesë unë do i përcjelli në departamentin për sinjalizim të rrugëve. Për momentin ne në kët pjesë veprojmë konform shenjave egzistuese .

Lirie Luta : Policia ka pasur aktivitete të përbashkëta me shkolla rreth vtdijësimit të nxënësve rreth pasojave të përdorimit të narkotikëve për çka edhe i përgëzoj . Më intereson të dijë se a ka raste që këto substanca janë gjetur tek nxënësit apo a është intervenuar në ndonjë lokalitet .

Jaser Jaha : Sa i përket sigurisë nëpër shkolla ne kemi planet tona që në bashkëpunim me drejtoret kemi organizuar aktivitete vtdijësuese të cilat aktivitete do të vazhdojmë edhe në të ardhmën . Situata në të gjitha shkollat është e mirë dhe nuk është ashtu siq edhe interpretohet .

Zahir Doda : Personalisht jam shumë i kënaqur me bashkëpunimin që kemi pasur me Policinë por që më shqetësojnë disa organizata joqeveritare formale dhe joformale që nganjëherë me aktivitete të panevojshme po cënojnë procesin mësimorë . E kuptoj që programet e tyre janë të nevojshme për tu realizuar por që procesi mësimorë nuk duhet penguar . Ka raste që disa prej tyre edhe i kam refuzuar dhe nuk kam ofruar bashkëpunim

Fatmir Qaka : Para se të vijë në takim mora një informacion se javën e kaluar ka ndodhur një rrahje në mes të dy grupeve të të rinjëve dhe njëri nga ky grup i të rinjëve ka kërkuar ndihmën mjeksore . Në bazë të informatave që kam situata në mes këtyre dy grupeve nuk është e mirë dhe mundë të ndodhë që prap kjo rrahje të përsëritet . Më intereson të dijë se a është në dijeni policia në lidhje me kët rast dhe nëse po çfarë masa janë ndërmarrë deri më tanë .

Një tjetër shqetësimështë edhe dukuria e bulizmit e cila po shfaqet në forma të ndryshme nëpër shkolla dhe rrugë. Shqetësuese është se kjo dukuri po ndodhë edhe tek tek nxënësit nga

klasa e I-rë deri te e V-ta . Mendoj se duhet të kontaktohen prindërit përmes takimeve në shkolla dhe të parandalojmë kët dukuri .

Jaser Jaha :Sa i përket rastit të konfliktit fizik në mes të dy grupeve të të rinjëve ne jemi të njoftuar në lidhje me kët rast dhe i kemi intervistuar personat e involvuar .

Nënkryetari : si bulizmi ashtu edhe dukuritë tjera devijante tek të rinjët duhet trajtuar dhe duhet gjetur forma që ti parandalojmë .

Kjani Sallahu : Kisha me i ngritë disa shqetësimë të qytetarëve duke filluar me telat e tensionit të lartë të rrjmës elektrike, shumë afër pullazeve të shtëpive në rrugën “Avdirrahim Shehu”. Të njoftohet KEDS dhe të bëjnë një zgjidhje ngase po krijojnë pasiguri tek qytetarët që banojnë në këtë pjesë të qytetit. Edhe në të kaluarën kemi ngritë shqetësimet rreth punimeve që bëjnë operatorë të ndryshëm nëpër trotuare. Mendoj se është neglizhencë e inspektorve komunalë që nuk ndërmarrin masa. Tregu i gjelbërt nuk i plotëson aspak kushtet dhe për të zhvilluar këtë veprimtari si duhet. Tregu i Gjelbërt ose duhet të rregullohet mirë ose duhet të mbyllët, sespe nuk lejohet që bylmetet, pemët e perimet, etj., të ekspozohen në hapësirë të kontaminuar nga plehërat, pluhuri, balta, etj. Është një shqetësim edhe i këshillit të nxënësve dhe prindërve të Gjimnazit „Skënderbeu”rreth ndërtimit të një pike të derivateve të naftës në afërsi të shkollës . Më intereson të di se a posedon leje ndërtimi dhe leje operimi ky biznes dhe nëse po kush është ai që lejoi ndërtimin e e këtij biznesi të rrezikshëm për sigurinë e nxënësve të gjimnazit dhe të qytetarëve. Duhet të trajtohet dhe rishikohet ky problem.

Ramadush Osmani : leje ndërtimi mirren pran Drejtorisë së Urbanizmit dhe Katastër në komunë , ndërsa sa i përket rrezikshmërisë dhe ruajtjes së ambientit si dhe leje të punës janë Ministritëqë mirren me këto qështje. Sa i përket tregut të gjelbërt për momentin nuk kemi hapsirë për zhvendosje , e në lidhje me shqetësimet e telave të tensionit të lartë afër pullazeve të shtëpive ne sot kemi një takim me zyrtarë nga KEDC dhe do e paraqesim kët shqetësim . Ndaj punimeve siq janë saldimet , xham prerja që bëhen nëpër trotuare ne ua kemi tërhjekur vërejtjen personave që mirren me këto veprimtari dhe në të ardhmën do të ndërmarrim masa .

3.Dukuria e vjedhjeve masive në disa lokalitete të komunës së Kaçanikut

-Në pikën e tretë të rendit të ditës , zv.Komandanti i Policisë tha se në zbulimin e rasteve të vjedhjeve që kan ndodhë muajë më parë ne kemi zhvilluar veprime të ndryshme duke filluar me takime me banorë të prekur nga kjo dukuri , takime me institucione komunale dhe po mundohemi maksimalisht në zbulimin e rasteve . Janë intervistuar shum persona të

dyshuar dhe disa prej tyre janë në procedurë të hetimit .Kohëve të fundit kjodukuri ka rënje të theksuar falë angazhimit të përbashkët të institucioneve të sigurisë dhe qytetarëve.

Nënkryetari :Falë bashkëpunimit dhe koordinimit të punëve situata ka ndryshuar për të mirë , por që duhet të jemi syqelë për ta luftuar kët dukuri .

4.Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBS-së në vitin 2019

Kjani Sallahu: Rekomandimet i keni përpara dhe ne mundë të diskutojmë rreth asaj se çka është bërë dhe çka jo.

Fadil Guri : Rekomandimet ndërlidhen më së shumti me shërbimet publike dhe Drejtori mundë të na tregoj më mirë rreth asaj se çka është ndërmarrer rreth zbatimit të këtyre rekomandimeve .

Ramadush Osmani : i kam lexuar me vëmendje rekomandimet nga viti i kaluar dhe mundë të themi se është punuar mjaftë dhe disa punë që nuk janë kryer do të vazhdojmë në të ardhmën të i kryejmë .

-Drejtori raportoi për secilin rekomandim e sidomos për krijimin e hapsirave për parkingje , furnizimin e qytetarëve me kontanjer , largimin e hendeqeve nëpër rrugë etj.

Zahir Doda : si pikë kritike mbetet vendosja e laurave te hekurudha afér ETC që të dërgon te shkolla fillore „Emin Duraku “. Është shqetësuese ngase frekuentojnë një numër i madh i fëmijëve .Komuna u ka bërë kërkësë departamentit të hekurudhave në nivel qendrorë por që deri më tanë nuk ka asgjë në kët drejtim .

Lirije Luta : Rreth kësaj problematike ka pasur ankesa edhe nga delegatët e Asamblesë Komunale dhe është mirë që të mirren masa që të mirren ide të mira në zgjidhjen e këtij problemi .

Fadil Guri : e përkrahim kët shqetësim të Drejtorit të Arsimit por që kam një informacion se egziston një projekt që do të realizohet në lidhje me kët problematikë por që ky problem do zgjidhje të shpejtë . Sa i përket rekomandimeve një shqetësim e kam paraqitë disa herë vitin e kaluar rreth bllokimit të rrugës „Feriz Guri “në fshatin Nikaj . Punët kan pas filluar por që ende nuk janë kryer . Në kët rrugë gjithashtu mungon edhe sinjalizimi . Rreth kësaj problematike të jepin ide expertët e lëmive dhe të bëhet një zgjidhje e shpejtë.

Ramadush Osmani : Në territorin tonë kemi edhe rrugë që menagjohen nga niveli qendororëdhe ne nuk kemi kompetenca por që shqetësimet i kemi ngritë . Sa i përket problematikës së rrugës në fshatin Nikaj ne kemi ndërmarrë masa por që pengesat po dalin nga vet banorët e kësaj ane . Ne në komunë kemi zyrtarë expert që mirren me kët punë por që edhe banorët e kësaj ane të gjejnë një gjuhë të përbashkët për zgjidhjen e këtij problemi

Nënkyryetari : Ndër rekomandimet ishin edhe parandalimi i dukurive negative tek të rinjët . Është mirë që nëpër shkolla të zhvillohen aktivitete parandaluese për këto dukuri .

Fidaim Fazliu : jam i nderuar që gjindem në kët këshill dhe mundë të them që kam përcjellë aktivitetet e këtij këshilli të cilat aktivitete janë mbresëlënëse . Kontributin tim do ta jap përmes ligjeratave dhe aktivitetave tjera në të gjitha xhamitë që gravitojnë në territorin e komunës tonë . Jam për një bashkëpunim me të gjithë akterët e sigurisë për të penguar qdo dukuri negative . Është një e mirë që egziston një forum i tillë që mirret seriozisht me sigurinë qytetare . Kam një kërkesë tek policia që të jet më efikase në ndriçimin e rasteve ngase kam një përshtypje që nganjëherë nuk reagohet si duhet e në kët rast po e përmendi parkimi i veturave pran xhamisë së qytetit që po pengojnë kryerjen e shërbimeve .

Lulzim Uka : Ne si FSK kemi lexuar rekomandimet dhe nuk kemi parë diqka që na është dhënë detyrë për të kryer por që në të ardhmën ne jemi të gatshëm për çdo bashkëpunim .

5. Të ndryshme

Lirije Luta : Mendoj që prioritet duhet të ju ipet shkollave duke u ofruar programe të ndryshme edhe jashtë shkolllore

Shemsedin Abazi : KLSP është në pritje të implementimit të një projekti në ndriçimin e hapsirave të jashtme shkolllore

Jashar Selimi : Këshilli i prindërve kemi mbajtë disa takime ku jemi munduar të japim kontributin tonë aty ku është dashur të kontribojmë .

REKOMANDIMET:

1. Të përcillen shqetësimet në nivelin qendrorë rreth mungesës së shenjave informuese dhe ndriçimit në kyqjen e autostradës në Fushën e Pajtimit
2. Lokacioni i Tregut të Gjelbërt ose duhet të rregullohet ose duhet të mbyllët apo zhvendoset tregu
3. Të organizohen më shumë aktivitete vetëdijësuese nëpër shkolla rreth dukurive negative e në veçanti për narkotikët dhe dukurinë e bulizmit
4. Të organizohen takime më të shpeshta nëpër shkolla me prindë
5. Të pengohet zhvillimi i veprimtarive të ndryshme biznesore nëpër trotuare


Pas këtyre diskutimeve Nënkyetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kaçanik 26.02.2020

Kryesues:

Nënkyetari i Komunës

z. Ylber Bajra



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka

